



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të grupit të operatorëve ekonomik "Sahit Mecini" B.I. & "N.N. 100% Design" Sh.P.K. të datës 22.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 17.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe rregullimi i tërësishëm i sistemit të klimatizimit në objektin e ri të Komunës" me nr. të prokurimit 616-23-7990-1-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim të grupit të operatorëve ekonomik "Sahit Mecini" B.I. & "N.N. 100% Design" Sh.P.K. e datës 22.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 17.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi, montimi dhe rregullimi i tërësishëm i sistemit të klimatizimit në objektin e ri të Komunës" me nr. të prokurimi 616-23-7990-1-2-1.
- II. **VËRTETOHET** vendimi i zyrtarit përgjegjës të prokurimit i datës 24.08.2023 për të dërguar në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me të dhëna si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Sahit Mecini" B.I. & "N.N. 100% Design" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Sahit Mecini" B.I. & "N.N. 100% Design" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 19.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 17.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, montimi dhe rregullimi i tërësishëm i sistemit të klimatizimit në objektin e ri të Komunës" me nr. prokurimi 616-23-7990-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 3

**Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:**

- “Ne kemi ofertuar me tender të përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit me çmim më të lirë”.
- “Pas qasjes në dokumentet e OE të propozuar nga AK, ne kemi hasur në falsifikim në data dhe numra të certifikatave të ISO standardeve... OE i propozuar nga AK certifikatën ISO 7168:1984 e ka të lëshuar me datë 03.08.2023 ndërsa noterizimi është bërë një ditë më herët para ditës së lëshimit dmth me datë 02.08.2023... Këto certifikata janë të noterizuara mirëpo ajo që vlen të theksohet është se në përmbajtje noteriale nuk përmbajnë në tekst asnjë numër të certifikatave për dokumentimin dhe identifikimin e noterizimit të tyre... OE i rekomanduar nga AK ka paraqitur një raport final të bërë nga një kompani e caktuar mirëpo ajo që duhet të potencohet është se data e lëshimit është para periudhës kohore të mbikëqyrjes nga ana e kompanisë që ka lëshuar dokumentin pra periudha e mbikëqyrjes është 15.03.2023-15.05.2023 ndërsa data e lëshimit është 05.05.2023”.

Për shkak të këtyre pretendimeve të cituara si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59 dhe 60 të LPP.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se kërkesa e dosjes së tenderit të cilës i referohet pretendimi ankimor është kërkesa e tretë dhe e katërt në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional (kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - 9.1 & 9.2) e cila është përcaktuar si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<b>Kapaciteti teknik dhe profesional</b> 3. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë Iso Standardet si në vijim a) Iso 9001 2015; Managment b) Iso 45001 2018; Safety and Health c) Iso 7168 1985 - Air Quality 4. Operatorët Ekonomik duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin sipas kërkesave të Ligjit 04 L-161 për Siguri dhe Shëndet në punë.	<b>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</b> Kopjen e certifikatave të noterizuara me validitet për vitin 2023  4. Operatorët Ekonomik duhet të dëshmoj raportin e vlerësimit të rrishtit për të gjitha pozitat e organogramit dhe organizimit të kompanisë nga një kompani e licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
---	-----------	---	--

Tutje përmes njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 17.08.2023, tenderuesi i rekomanduar për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit është grupi i operatorëve ekonomik “Ego Elsa” Sh.P.K & “Terminal Group” Sh.P.K.

Nga dosja me të cilën ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është gjetur se ndër të tjera është dorëzuar edhe certifikata ISO 7168:1985 e lëshuar më (issue date) 03.08.2023. Ky dokument është dorëzuar si kopje e vërtetuar te noteri sipas vërtetimit LRP.nr.6673/2023 të datës 02.08.2023. Në këtë mënyrë është gjetur se kopja e vërtetuar e noterit është bërë një (1) ditë më herët sesa data e lëshimit (issue date) e dokumentit në fjalë. Njëkohësisht është gjetur se në tekstin e vërtetimit noterial nuk është cituar fare dokumenti origjinal i cili është vërtetuar nga noteri përkatës. Përndryshe certifikata ISO 7168:1985 është evidentuar edhe si kërkesë e dosjes së tenderit sikurse është cituar më sipër në vendim.

Njëkohësisht është gjetur se në kuptim të kërkesës nr. 4 të kapacitetit teknik dhe profesional të cituar si më sipër, tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar edhe një raport për vlerësimin e riskut për periudhën kohore 15.03.2023 – 15.05.2023 mirëpo i cili raport është nënshkruar me datë 05.05.2023.

Komisioni i rivlerësimit në kuptim të nenit 59 të LPP ka përgjegjësi për të ekzaminuar, krahasuar dhe vlerësuar në tërësi të gjithë tenderët duke përfshirë edhe ndërmarrjen e veprimeve për të identifikuar tentimet eventuale për të ofertuar me dokumente të cilat kanë përmbajtje jo të saktë (mashtuese). Për këto qëllime komisioni i vlerësimit ka mundësi që të kërkojë edhe sqarime shtesë nga tenderuesit në kuptim të nenit 38 të RRPP. Në rastin konkret gjatë rivlerësimit komisioni rivlerësues duhet të ndërmerret masat dhe veprimet e nevojshme sipas ligjit për të vërtetuar gjendjen faktike të cilën e pretendon parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim duke synuar që të konfirmohen ose jo edhe të gjeturat më sipër këtë vendim.

Sa i përket pikës së pretendimit ankimor se parashtruesi i ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, i njëjti të gjitha pretendimet ankimore i ka formuluar kundër tenderuesit të rekomanduar dhe nuk ka paraqitur argumente të mjaftueshme për të vërtetuar të kundërtën e arsyeve për të cilat është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Për këto arsye është miratuar si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit. Duke vendosur sipas një tjetër kërkesë për rishqyrtim lidhur me këtë aktivitet të prokurimit të parashtruar nga një tjetër operator ekonomik, zyrtari përgjegjës i prokurimit me datë 24.08.2023 ka marrë vendim për të kthyer në rivlerësim këtë aktivitet të prokurimit. Rrjedhimisht përmes pikës II të këtij vendimi vetëm është vërtetuar vendimi tjetër i datës 24.08.2023 për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.